



Prishtinë, 27.02.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3082_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2808_12_25** i datës 04.12.2025;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 26.12.2025.

në seancën e mbajtur më datë 27.02.2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **M.M.**, nga Komuna e Gjilanit, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRe, me nr. ZRRE/DMK_V_2808_12_25 i datës 04.12.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRe, me datë 04.12.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2808_12_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit M. M., lidhur me kontestimin e faturës me nr. 01250DGL - 9004788 e dt. 01.02.2025 dhe korrigjimit financiar me nr. 29139DGL – 90004788 i dt. 07.02.2025 dhe e ka obliguar KESCO-n, që për vlerën e mbetur nga korrigjimi, konsumatorit t'i ofroj kontratë pagese për periudhën kohore prej 121 muajve.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRRe-së, për këto shkaqe:

- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Zbatimit të gabuar të Ligjit për Energjinë dhe
- Mungesës së përgjegjësisë së konsumatorit për obligimin e krijuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 ka analizuar të gjitha shkruesat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Transaksionet e konsumatorit, Rrjedha e Energjisë Elektrike, Listat e Leximit, Korrigjimin Financiar të datës 07.02.2025, procesverbalin e inspektimit nr.2119887 date 30.10.2024 si dhe procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 0024147 date 04.04.2025 si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike dhe analizimit të listave të leximit konstatohet se punëtorët e autorizuar të KEDS për leximin e pikave matëse kanë bërë inspektime të rregullta mujore por që vërtetohet se nga periudha 01/2015 deri në periudhën 12/2024 kanë evidentuar vetëm shpenzimet në Tarifën e Ulët kurse në periudhën 01/2025 është evidentuar lexim CCP duke faturuar konsumatorin me TL=44292 kWh dhe TU=846 kWh, në periudhën 03/2025 është evidentuar “Defekt me shpenzim/Vlerësuar”. Bordi duke u bazuar në shqyrtimin e rrjedhës së energjisë elektrike, listave të leximit konstaton se KESCO me rastin e faturimit të konsumatorit për shpenzimet e periudhës kontestuese, përfshi edhe faturën e periudhës janar 2025 (faturën nr. 01250DGL-9004788), përkatësisht për periudhën Janar 2015 deri në periudhën janar 2025 ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.

Bordi po ashtu, ka shqyrtuar procesverbalin e inspektimit nr. 2119887 të datës 30.10.2024 ku ekipet e KEDS-it përveç të dhënave teknike të pikës matëse kanë evidentuar edhe gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 63987723 ku TL=42644 kWh dhe TU=17613 kWh. Po ashtu është evidentuar vërejtja se: *“Kemi dalë në vendin e ngjarjes dhe gjendja reale është I=42644 dhe II=17613”*. Pas analizimit të gjendjes së shpenzimeve të evidentuar në procesverbal, vihet re që kjo gjendje nuk përputhet me gjendjen e leximeve dhe faturimeve deri në këtë periudhë, përkatësisht për shpenzimet e regjistruara në tarifën e lartë.

KEDS po ashtu ka ofruar edhe procesverbalin me nr. 0024147 të ndërrimit të njehsorit elektrik me të cilin vërtetohet se me datë 04.04.2025 është larguar nga matja njehsori elektrik nr. nr. 63987723 me gjendje të shpenzimeve TL=45422 kWh dhe TU=19218 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 40182933 me gjendje të shpenzimeve TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Gjendja e shpenzimeve po ashtu vërtetohet edhe me fotografi të njehsorit në momentin e ndërrimit ku TL=45422 kWh dhe TU=19218 kWh.

Bordi i ka shqyrtuar Korrigjimet Financiare nr. 29139DGL-9004788, 29138DGL-9004788 dhe 29137DGL-9004788 të datës 07.02.2025, të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO në vlerë prej -990.14€, në të cilat është evidentuar si vijon: *“Shpërndarje e kWh për periudhën 01/2015 deri 01/2025 pasi gjatë ndërrimit në muajin 01/2015 T1 është mbetë gjendja e njehsorit të vjetër dhe nuk është*



faturuar deri ne muajin 01/2025, bazuar ne procesin nr. 2119887 i datës 30.10.2024 A1= 42644 kWh dhe A1=17613 kWh dhe rrjedhën e energjisë elektrike”, dhe ka gjetur se, ky korrigjim është i saktë si dhe që KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike ku thuhet se: 3. *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*. Bordi duke pasur parasysh se te dhënat e rifaturuara janë nxjerre nga njehsori elektrik bazuar në matjet/leximet me sondë, ka bërë shpërndarjen e kWh per periudhën 01/2015 deri në periudhën 01/2025 por që konstaton se konsumatorit nuk i takon korrigjim tjetër financiar. Andaj, duke pasur parasysh se konsumatori nuk ka pasur lexime dhe faturime të rregullta të shpenzimeve për periudhën 01/2015 deri në periudhën 01/2025 kërkon që KESCO per pjesën e mbetur te faturës t’i ofroj konsumatorit kontratë pagese për periudhën kohore 121 mujore.

Nga analizimi i ankesës së konsumatorit, Bordi vëren se konsumatori përveç kontestimit te faturimit nga ana e KESCO-s, per periudhën kontestuese po ashtu ka kontestuar kërkimin e borxhit te krijuar deri ne periudhën 2024 me arsyetimin se i njëjti është parashkruar dhe se ndërmarrja nuk ka të drejtë që ta kërkoj këtë borxh prej tij. Lidhur me këtë çështje ju njoftojmë si vijon, ZRrE prej vitesh mban qëndrim që parashkrimi si institut i së drejtës materiale, nuk trajtohet dhe nuk shqyrtohet në procedure administrative dhe në nivel të organeve administrative, për shkak që, kjo çështje është në kompetencën e gjykatave të rregullta në nivel vendi, si çështje kontestuese e natyrës juridiko – civile dhe atë, duke iu referuar nenit 341 – Rregullat e Përgjithshme, të Ligjit nr. L/07-044, për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si vijon: *“Gjykata (theksi i shtuar) nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë”*. Për më tepër, ky qëndrim i ZRrE-së është rikonfirmuar edhe përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, përmes Aktgjykimit me shenjen ARJ.nr.92/2024, i dt. 26.07.2024, ashtu që, ndër të tjera ka konstatuar se, shqyrtimi dhe vlerësimi i parashkrimit të borxhit, duhet të bëhet nga Gjykata, ashtu siç parashihet me ligj rregullimi i këtij instituti dhe e ka obliguar Gjykatën Themelore që në riprocedurë të vlerësoj çështjen e parashkrimit të borxhit, duke i vlerësuar provat dhe faktet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse.

Tutje, Bordi thekson se, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **M. M.**,
- Arkivit të ZRrE-së